



# RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR

Për vitin që përfundon 31 dhjetor 2023

---

*KF „DUKAGJINI” OJQ*

---

**KLINË, PRILL 2024**

## Përmbajtja

Përmbajtja .....	2
1. Informacion i përgjithshëm i OJQ-së .....	9
2. Qëllimi: .....	10
3. Aktivitetet e Organizates .....	10
5. Njohja e të ardhurave.....	11
6. Njohja e Shpenzimeve .....	12
7. Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parave të gatshme .....	12
8. Tatimi ne fitimit .....	13

# **FRYTI SH AUDIT**

Adresa: Zona industriale Zahaq – Pejë

Tel: +38344489047

Email: [frytiauditshpk@hotmail.com](mailto:frytiauditshpk@hotmail.com)

## **RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**

*Për Menaxhmentin e ndërmarrjes KF"DUKAGJINI" KLINË*

*Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare*

### **OpinionI**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të KF"DUKAGJINI" KLINË, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, pasqyra e fitimit ose humbjes dhe pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, bashkangjitur shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Ndërmarrjes më datën 31 Dhjetor 2023, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM).

### **Bazat për opinionin e pakualifikuar**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre Standarteve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit tonë për përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare, Ne besojmë së evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

✦ Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për pasqyrat financiare Menaxhmenti i shoqërisë është përgjegjës për përparatjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") për NVM, dhe për kontrollin e brendshme, të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për përparatjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përparatjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë që të vazhdojë aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet e lidhura më

vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit më parim të vijimësisë përveç nese menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë shoqërinë ose të ndërprejë operacionet, ose nuk ka alternativë reale tjetër përpos ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

#### ✦ Përgjegjësitë e auditorit për auditimin, e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticism profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë.
- Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmatjeve kontabël, si dhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga menaxhmenti.
- Arrijmë në përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe bazuar në evidencën e sigurnar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të lindin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vijuar aktivitetin. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të auditorit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së aktivitetit të shoqërisë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontroleve të brendshme që identifikojmë gjatë fund vitit tonë.

Fryti Sh Audit  
Adresa: Zona industriale Zahaq – Pejë  
Vendi: Pejë – Republika e Kosovës  
Data: 02.04.2024  
ID 5473

Praktikuesi i pavarur  
Diedon Berisha- Auditor Ligjor






## BILANCI I GJENDJËS

	31.12.2023	31.12.2022
<b>MJETET</b>		
Mjetet qarkulluese		
Keshi (arka,xhirollogaria)	1,009	425
<b>Gjithsej mjetet qarkulluese</b>	<b>1,009</b>	<b>425</b>
 Mjetet fikse		
<b>Gjithsej mjetet fikse</b>		
 <b>GJITHSEJT MJETET</b>	<b>1,009</b>	<b>425</b>
 <b>DETYRIMET DHE EKUITETI</b>		
Detyrimet afat-shkurta		
Detyrimet tjera afat-shkurtëra		
<b>Gjithsej Detyrimet afat-shkurtra</b>		
 Detyrimet afat-gjata		
Huatë afat-gjata		
Pjesa afat-gjate për shfrytëzimin e mjeteve		
<b>Gjithsej detyrimet afat-gjata</b>		
 <b>GJITHSEJT DETYRIMET</b>		
Fondet	425	4,429
Rezervat tjera	0	0
Teprica /Mungesa e te hyrave	584	-4004
<b>GJITHSEJ EKUITETI</b>	<b>1,009</b>	<b>425</b>
 <b>GJITHSEJ DETYRIME DHE EKUITETI</b>	<b>1,009</b>	<b>425</b>

Kryetari i klubit

per 



Drejtori Financiar

per 

**K.F. DUKAGJINI , KLINË**

Nr.Regj. 5110760-8: NRF: 601830145

**PASQYRA E TË ARDHURAVE**

	01.01-31.12.2023	01.01-31.12.2022
Te hyrat nga Sponzorizimi	188,964	75,790
Të hyrat nga FFK	724,344	258,700
		-
<b>Kostoja e mallit të shitur</b>		-
		-
<b>Bruto fitimi</b>	<b>913,309</b>	<b>334,490</b>
<b>Shpenzimet operative:</b>		-
Pagat/Rrogat	888,183	244,238
SPI		
Shpenzimet per blerje operative	22,652	77,274
Provizionet bankare	1,890	833
Shpenzimet tjera per udhetime		16,149
Gjithsej shpenzimet operative		
<b>Fitimi /humbja operacionale</b>	<b>912,725</b>	<b>338,494</b>
<b>Fitimi / humbja neto para tatimit dhe dividendës</b>		<b>0</b>
<b>Neto fitimi/humbja</b>	<b>584</b>	<b>4,004</b>

**K.F. DUKAGJINI , KLINË**

Nr.Regj. 5110760-8: NRF: 601830145

**Pasqyra e rrjedhës se parase**

	<b>2023</b>	<b>2022</b>
<b>Aktivitetet Operative</b>		
Te hyrat tjera nga subvencionet	913,309	334,490
Aktivitete e ndryshme operative	912,725	338,494
Diferenca në Llogarit e Arkëtueshme, tregtare	-	-
Diferenca në Llogarit e Pagueshme, tregtare	-	-
Diferenca në shpenzimet e parapaguara	-	-
Tjera	-	-
<b>A Rrjedha e Paras nga Ak. Operative</b>	<b>584 -</b>	<b>4,004</b>
<b>Aktivitetet Investuse</b>		
Objetet	-	-
Paisjet	-	-
<b>Rrjedha e Paras nga Ak. Investuse</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>B Aktivitetet Financuse</b>		
Kthimi i mbitërheqjeve	-	-
Huazimet tjera	-	-
<b>C Rrjedha e Paras nga Ak. Financuse</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Rrjedha e paras nga aktivitetet (A+B+C)	584	-4,004
Rrjedha e paras në fillim	425	4,429
<b>Paraja e gatëshme në fund</b>	<b>1,009</b>	<b>425</b>



## Shenimet/shpjegimet e pasqyrave financiare

31.12.2023

### 1. Informacion i përgjithshëm i OJQ-së

OJQ "KF DUKAGJINI" në KLINË, është një Organizatë Joqeveritare e regjistruar pranë Federatës së Futbollit të Kosovës e cila është e licencuar në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04 / L-57. Për lirinë e shoqatës së organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës, datë 22.02.2006.

- Çertifikata e regjistrimit është me numri 5110760-8
- Çertifikata e numrit fiskal është me numer 601830145

Organizata e ka zyrën e saj qendrore në Klinë, Rr.Abedin Rexha- Ndertesa e Kuvendit Komuna

Themelues të organizatës janë:

1. Binak Kalludra
  2. Fabion Veseli
  3. Valon Duraku
  4. Naser Kalludra
  5. Ramush Agushi
  6. Isuf Berisha
  7. Xhafer Berisha
  8. Burim Hoti
  9. Hasan Gashi
  10. Alban Berisha
- Gjithsejt 25 persona

Organet dhe Menaxhimi

Shefi Ekzekutiv i Shoqatës së Kosovës është Z. Fabion Veseli

Organet dhe Menaxhimi

Organet e OJQ-së KF "DUKAGJINI" në KLINE janë:

1. Kuvendi i Organizatës
2. Bordi i Organizatës
3. Kryeshefi Ekzekutiv-Drejtori

Kuvendi është organi më i lartë drejtues në këtë organizatë dhe përbëhet vetëm nga anëtarë të rregullt të organizatës.

- Kuvendi i Organizatës është përgjegjës për krijimin e shoqatës do të ketë edhe përgjegjësinë për politikën e udhëhequra nga organizata dhe çështjet financiare të organizatës

- Bordi I Organizates përbëhet nga anëtarë të organizatave joqeveritare, ekspertë të fushave të ndryshme.

- Bordi është përgjegjës për udhëheqjen e shoqatës. Atij i përkasin të gjitha detyrat, të cilat sipas statutit nuk i përkasin ndonjë organi tjetër të administrimit si:

1. Vendimi në lidhje me buxhetin vjetor të propozuar dhe raportet financiare të lidhura dhe bilancin financiar.

2. Mbështetni Menaxhimin në kryerjen e detyrave

3. Përgatitja e mbledhjes së Kuvendit,

4. Shoqata e administrimit të pasurive.

## **2. Qëllimi:**

- 2.1. Organizata (Klubi) është themeluar me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve sportive si dhe zhvillimin e lojës së futbollit në përgjithësi

## **3. Aktivitetet e Organizates**

- 3.1. Për t'i përmbushur qëllimet e sajë, organizata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në këto, aktivitetete të lartshënuara..

- Krijon kushte materiale të klubit;
- Synon edukimin e punës profesionale në klub me futbollist
- Bënë prezantimin e klubit në garat e futbollit në nivele vendore deri ato ndërkombëtare.
- Pjesëmarrje në turnirët regjionale, kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Pjesëmarrje në aktivitete Edukative, Arsimore, Sportive, Kulturore dhe Bamirëse.

## **4 Politika kontabël**

Politikat kontabël të adoptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë të paraqitura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse është e theksuar ndryshe.

#### 4.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat e shpenzimeve janë përgatitur nën parimin e kostos historike dhe bazuar mbi parimin e vijimësisë.

Përgatitja e pasqyrave të shpenzimeve në përputhje me Standardet e shënuara më sipër kërkon nga menagjimenti që të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumën e raportuar të aktiveve dhe detyrimeve dhe paraqitjen e aktiveve dhe detyrimeve kontigjente në datën e pasqyrave financiare dhe shumën e raportuar të të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën e raportuar.

Këto pasqyra janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023. Të dhënat aktuale dhe krahasuese janë të shprehura në Euro.

Përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël të aplikuara në përgatitjen e pasqyrave financiare është paraqitur si më poshtë.

Monedha funksionale dhe raportuese e Kompanisë është Euro që është një monedhë ligjore në territorin e Kosovës që nga 1 janari 2002.

#### 5. Njohja e të ardhurave

OJQ KF DUKAGJINI të ardhurat për vitin 2023 rrjedhin kryesisht donacionet nga bizneset e bazuara në ligjin 05/L-090, si donacione të lejuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Kontratat e nënshkruara nga OJQ KF DUKAGJINI të cilat i ka arketuar në llogarinë bankare 17092000090028597 NLB Banka për të cilat donacione është leshuar edhe vertetimet nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve janë :

Te hyrat tjera nga

FEDERATA E FUTBOLLIT TE KOSOVES	724,344.00€
TE HYRAT NGA DONACIONET	188,964.00€
<b>GJITHSEJTYT TE HYRAT</b>	<b>913,309.00€</b>

## 6. Njohja e Shpenzimeve

Shpenzimet te mbuluara nga donacionet e pranuar nga donatoret jane te përmbledhura ne tabelat me posht si shpenzimet kryesore te Klubit .

### 6.1.Shpenzimet janë si në vijim :

Nr.	Përshkrimi i shpenzimit	Data e pagesës	Përfituesi	Vlera e paguar
1	paga	janar	Lojtaret/administrate	2,500.00
2	paga	shkurt	Lojtaret/administrate	20,486.00
3	paga	mars	Lojtaret/administrate	18,880.53
4	paga	prill	Lojtaret/administrate	89,872.90
5	paga	maj	Lojtaret/administrate	29,941.79
6	paga	qeshor	Lojtaret/administrate	70,618.41
7	paga	korrik	Lojtaret/administrate	158,382.17
8	paga	gusht	Lojtaret/administrate	202331
9	paga	shtator	Lojtaret/administrate	100974.2
10	paga	tetor	Lojtaret/administrate	118225.25
11	paga	nentor	Lojtaret/administrate	65529.25
12	paga	dhjetor	Lojtaret/administrate	10521.5
<b>Totali</b>				<b>888,263.00</b>

## 7. Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parave të gatshme

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përbëjnë saldon e parave të gatshme ne arke dhe saldon në llogarin bankare.

- Gjendja përfundimtare në bankë me datën 31.12.2023 është 1,009.21€

PARAJA NE FILLIM	01.01.2023	974.73 €
TE HYRAT GJATE VITIT NE LLOGARINE BANKARE		913,309.00 €
Huazimet e marra gjate vitit dhe kthimet e transfereve gabim		33,925.00
<b>TOTAL PARAJA E GATSHME PER SHPENZIM</b>		<b>948,208.73 €</b>
SHPENZIMET GJATE VITIT 2022		912,725.25 €
kthimet e huazimeve dhe terheqjet		34,474.27
PARAJA NE FUND	31.12.2023	1,009.21 €



Klubi Dukagjini gjate vitit 2023 edhe pse ka pasur te hyra te konsiderueshme dhe me te larta siq kishte ne vitin 2022 ka pasur nje rritje te shpenzimeve si pasoje e shtimit te aktiviteteve dhe kapaciteteve sportive,

## 8. Tatimi ne fitimit

OJQ KF "DUKAGJINI" është themeluar si organizatë jo fitimprurëse dhe për këtë arsye është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin. Organizata nuk ka llogaritur ndonjë pasiv të ndryshuar tatimore ose aktiv qe nga viti 2023 gjithashtu nuk ka ndryshime të përkohshme në këto të dhëna.

### Kontigjentet dhe detyrimet

- Detyrimet tatimore

Librat tatimor dhe regjistrimet e Kompanisë për vitin 2023 nuk janë inspektuar nga autoriteti tatimor vendor.

Detyrimet e tatimeve të kompanisë nuk mund të konsiderohen të përfunduara.

- Detyrimet kontigjente

OJQ KF "DUKAGJINI" nuk ka paraqitur në pasqyrat financiare asnjë detyrim kontigjent.

- Ngjarjet pas datës së pasqyrës së pozitës financiare

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasuese pas datës së pasqyrës së pozitës financiare për të cilat të ketë nevojë për rregullime ose shënime shpjeguese në këto pasqyra financiare.

- Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikun me 31.03.2024